



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Kaçaniku  
Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

1	Data 20.05.24	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	37901-1974	

## KONTRATA PËR SHËRBIME

**Komuna e Kaçanikut** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha –Menaxher i prokurimit**; në njëri anë dhe

**NHSH "LEONI - I"**, **Shkëmbim Dema B.I** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga **Sali Dema** përfaqësues në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

### “Shërbimet e byfësë”

Kontratë njëvjeqare me numër Identifikues **KA652/24/024/236 (652-24-3457-236)**.

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë “**Shërbimet e byfësë**”.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **20.05.2024** dhe përfundon më **19.05.2025**

Kontrata mund të ndërprehet edhe para datës së skadimit në rast të demolimit të objektit të komunes me paralajmërim prej së paku 10 ditë më heret.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se **një vitë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi i **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 2            Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3            Çmimi**

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PJESA A						
Pesha sipas kategorive - 60%						
NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	VENDI I ORIGJINËS
	Pije të nxehta					
#	Kafe makato e vogël	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe makato e madhe	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe Express e gatë	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe Express e shkurtë	copë	1	0.50	0.50	
#	Kafe turke	copë	1	0.40	0.40	
#	Kafe kapuçino	copë	1	0.30	0.30	
#	Nes café	copë	1	0.50	0.50	
#	Qumësht me çokoladë	copë	1	0.50	0.50	
#	Çaj i zi në gota të vogla 0.10 liter	copë	1	0.10	0.10	
#	Çaj të ndryshëm në filtera	copë	1	0.40	0.40	
<b>TOTALI PJESA A - PIJE TË NXEHTA</b>					<b>4.20</b>	

PJESA B						
Pesha sipas kategorive - 40%						
NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €	VENDI I ORIGJINËS
	Pije të ftohta					
1	Pije në kavanozë 0.33 liter	copë	1	0.80	0.80	
2	Lëngje Frutashë paketim qelqi 250ml	copë	1	0.80	0.80	
3	Ujë të gazuar 0.5 liter	copë	1	0.40	0.40	
4	Ujë të pagazuar 0.5 liter	copë	1	0.40	0.40	
#	Ujë të pagazuar me paketim qelqi 0.25 liter	copë	1	0.50	0.50	
#	Ujë të gazuar me paketim qelqi 0.25 liter	copë	1	0.50	0.50	
<b>TOTALI PJESA B - PIJE TË FTOHTA</b>					<b>3.40</b>	

<b>TOTALI PJESA A - PIJE TË NXEHTA 60 poena</b>	<b>4.20</b>
<b>TOTALI PJESA B - PIJE TË FTOHTA 40 poena</b>	<b>3.40</b>
<b>Totali</b>	<b>7.60</b>

Çmimi me I lirë me poentim Totali pjesa A pije të nxehta 60 poena dhe Totali pjesa B Pije të ftohta 40 poena

Identifikim i operatorit ekonomik (ue)	
Furi i or:	Shtetshumë Dëputi
Furi dhe mbiemri i përfaqësuesit të ue:	Shtetshumë Dëputi
Nëmbkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	13.04.2024
Vula:	

OE obligohet që në emër të qiraxë majore për shfrytëzim të hapësirës në objektin e administratës Komonale të paguaj 100.000 në Bëgërin e bashkë të komonës



### 3.1

**-OE NHH "Leoni" në bazë të DT obligohet në emer të qerasë mujore për shfrytëzimin e hapsires në obj. e Adm. komunale ti paguaj 100.00€ në llog. e buxhetit të komunës më së largu gjer me 15 të muajit vijues.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

## **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

**-Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë**  
**- Pagesa bëhet pas raportit me shkrim nga ana e Menagjeri i Kontrates për shërbimet e kryera.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

**6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Të respektohet kodi i veshjes për shërbimet te hotelerisë.**

## **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të jetë deri në kryerjen e shërbimit

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së

kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori

Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Kontrata mund të ndërprehet edhe para dates së skadimit në rast të demolimit të objektit të komunes me paralajmërim prej së paku 10 ditë më heret, dhe Autoriteti kontraktues nuk ka obligim të siguroj hapsirën tjetër për vazhdimin e veprimtarisë.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.




**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, për Autoritetin Kontraktues(ZP dhe DUGJK), dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	<b>Shkëmbin Dema</b>	<b>Emri:</b>	<b>Shefket Koxha</b>
<b>Pozita:</b>	Pronar	<b>Pozita:</b>	<b>Menagjer i Prokurimit</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	10.05.2024	<b>Data:</b>	20.07.2024
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	